

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurit **G.L.**, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6597/17, të dt.14.12.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt.**20.03.2018**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6597/17, e dt.14.12.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: G.L., nga i ati Rr. dhe nëna V., e gjinisë G., i lindur me dt...., me vendbanim në Rr.”I.K.” në P., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, me nr. të ID ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e:

Me dt. 08.06.2017 rreth orës 14:35 në Rr.“N.T.” në F.K., i pandehuri ka kanosur punëtorin e Bankës E. tani të dëmtuarin B.I., ashtu që derisa i dëmtuari ishte duke e kryer detyrën në Bankën E., i pandehuri kishte thirrur në telefon nga numri ... lidhur me lënien peng të një veture dhe gjatë bisedës kishin filluar keqkuptimet në mes tyre, pastaj ishte acaruar situata dhe i pandehuri e kishte kanosur me fjalët “Tash unë vijë në bankë dhe të kallëzoj kush jam unë, do të nxjerr gërklanin”, me ç’rast te i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e shqetësimit, frikës dhe pasigurisë për jetë,-

- me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga Neni 185 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **300 (treqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **me tri këste mujore.**

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

Obligohet i pandehuri që ti paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të jenë sipas llogarisë së kësaj gjykate, dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B.I, me vendbanim në L., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.6597/17, të dt.14.12.2017, e ka akuzuar G.L., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Kallëzimi penal, Raporti fillestar policor i dt.08.06.2017, deklaratat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marr në bazë të nenit 450 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.5726/17, i dt.20.03.2018

Zyrtari Ligjor
Leutrim Hoti

Gjyqtarja,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.